Në një magazinë, zjarri në përgjithësi konsiderohet si rreziku më i madh. Kjo për shkak se shumë njerëz mund të ekspozohen ndaj rreziqeve të tilla si nxehtësia rrezatuese, shpërthimet, tymi i dëmshëm dhe avujt.

Shkaqet tipike të aksidentëve janë mungesa e motivimit të personelit, që megjithëse mund të njohë procedurën, por që në mënyrë të pavullnetshme ose shkujdesur nuk e ndjek siç duhet atë; mungesa e njohurive dhe ndërgjegjësimit rreth përmbajtjes dhe rrezikshmërisë së substancave dhe materialeve; gabime njerëzore nga mungesa e trajnimeve apo faktorë të tjerë njerëzorë. Te tjerë shkaqe për ndodhjen e aksidentëve mund të jenë projektimi i papërshtatshëm, instalime të gabuara ose një defekt në rrjetin elektrik, ose mirëmbajtja e gabuar ose e pamjaftueshme e ndërtesave dhe pajisjeve dhe/ose kushte të papërshtatshme të magazinimit, kontakt me nxehtësinë nga një zjarr i afërm ose nga një burim tjetër nxehtësie, kontroll i dobët i motorëve, duke përfshirë materialet tymëse, nxehtë në punë, pajisje elektrike etj.

5.1.1 Emetimet

Burimet kryesore të emetimeve të projektit, në lidhje me zhurmat dhe emetimet e gazrave, do të jenë automjetet, pirunat dhe vinçi, pajisjet/sisteme djegje, dhe çdo aksident ose dështim

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

i sistemit. Duke qenë se nuk kemi asnjë sistem me djegje, niveli i emetimeve pritet të jetë i papërfillshëm gjatë operacioneve rutinë, përveç rasteve kur sistemi pëson defekt ose në rast të aksidenteve.

Gazrat toksik si për shembull monoksidi i karbonit mund të lëshohen nga një zjarr që përfshin disa prej lëndëve apo materialeve që ruhen në magazine. Lëvizja e automjeteve dhe aktivitetet operacionale për ngarkimin dhe shkarkimin e automjeteve mund të jetë një arsye për krijimin e pluhurit.

5.1.2 Shkarkimet dhe derdhjet

Derdhjet e lëndëve kimike, të naftës ose ujit të ndotur përbëjnë rreziqe potenciale që mund të vij nga ngjarje ose aksidente, ngjarje atmosferike ose keqpërdorimi i protokolleve të SHSM (Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit)² ose mungesa e masave parandaluese, etj.

Megjithëse probabiliteti për shkarkime është i ulët, magazinat dhe objekti do të pajiset me një sistem dranzhimi dhe gropë për grumbullimin e shkarkimeve aksidentale të kimikateve të lëshuara. Zonat janë të pajisur me sistem për dranzhimin e ujërave të shiut, me grupa septike.

Lëndë kimike të tilla mund të treten në ujë, të jenë pezull ose të lundrojnë në sipërfaqe, duke ulur kapacitetin e ujërave sipërfaqësore për të ushqyer organizmat ujorë.

Të gjitha shkarkimet e lëshuara duhet të plotësojnë standardet dhe rregullat në Shqipëri për cilësinë, temperaturën dhe erën përpara setë shkarkohen në mjedis, duke përfshirë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177 të 31 Marsit, 2005, “Mbi Normat e Shkarkimeve të Ujërave të Ndotur”.

5.1.3 Prodhimi i mbetjeve

Gjatë aktivitetit rutinë për magazinimin e lëndëve dhe materialeve pritet që të ketë një prodhim minimal të mbetjeve, si për shembull substanca të vjetra dhe të skaduara, si dhe paketime materiale bosh. Mbetjet e rrezikshme, të cilat përfshijnë materiale gërryese, paraqesin rreziqe mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë në punë.

² HSE- Health, Safety and Environment

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRIBUTION*

Magazina do të përdoret vetëm për magazinim të përkohshëm të materialeve, ndërsa eliminimi i tyre do të ndërmerret nga një kontraktor i specializuar dhe i licencuar për trajtimin e mbetjeve.

Mbetjet do të magazinohen sipas të njëjtave parime për magazinimin e lëndëve/ materialeve, megjithatë kontejnerët e mbetjeve duhet të etiketohen qartazi si mbetje dhe informacioni përkatës për llojin dhe rrezikshmërinë e tyre të jetë i dukshëm.

5.1.4 Përdorimi i burimeve (kërkesat për ujë)

Uji do të nevojitet kryesisht për nevoja të brendshme, për larje, tauletet dhe dushet, si dhe për ujë të pijshëm.

5.1.5 Përfundimet

Në përfundim, mund të konkludojmë se mund të krijohen një numër rreziqesh minimale kur magazinohen substanca dhe materiale jo të rrezikshme të paketuara. Këto rreziqe mund të ndikojnë tek punonjësit që punojnë brenda zonave të magazinimit, publikun e gjerë përreth dhe mjedisin. Duke marrë parasysh vlerësimin e burimeve të rreziqeve, kushtet dhe situatat e rrezikshme mund të vijnë nga:

- Operacione rutinë (si magazinimi, transporti, mbartja, etj.) ose ndikimi i diellit ose temperaturës së lartë kombinuar me një mungesën e ventilimit.
- Ruajtja e gabuar e materialeve, menaxhimi i gabuar i substancave/materialeve të skaduara/të dala nga përdorimi,
- Ngjarje të zjarreve, përmbytjeve, etj.,:
- Rrezik nga shpërthimi nga temperatura e lartë ose mungesa e ventilimit
- Ndotja e ajrit, etj.

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

VI. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE POTENCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

6.1 Hyrje

Kjo pjesë identifikon dhe analizon ndikimet që mund të shkaktohen nga aktivitetet e propozuara të projektit. Si bazë për vlerësimin do të përdoren kushtet aktuale natyrore brenda zonës së projektit duke përfshirë rreziqet dhe ndikimet që nuk lidhen me projektin, por të identifikuar në përshkrimin e mjedisit ekzistues të projektit.

Duke u bazuar në përshkrimin e shkarkimeve, emetimeve, mbetjeve dhe rreziqeve kryesore që lidhen me projektin, ne do të jemi të aftë të identifikojmë dhe vlerësojmë potencialin mjedisor kryesor, ndikimet social-ekonomike dhe trashëgiminë kulturore për Bazën e Furnizimit duke marrë në konsideratë:

Zonat e ndikimit të identifikuar: një listë e zonave të ndikuara të cilat shihen si komponentët mjedisor, social-ekonomik, dhe të trashëgimisë kulturore (mbi njerëzit, shëndetin e njerëzve, faunën dhe florën, tokën, përdorimin e tokës, asetet materiale, cilësinë dhe hidrologjia e ujit, cilësia e ajrit, klimës, zhurmës dhe vibrimit, peisazhin dhe mjedisin vizual, burimet historike dhe të trashëgimisë kulturore, dhe ndërveprimet ndërmjet tyre) që potencialisht mund të ndikohen nga aktivitetet e projektit.

Përshkrimi i ndikimeve: Një përshkrim i shkurtër i ndikimeve të mundshme ose burimeve të ndikimeve që mund të ndodhin nga projekti mbi bazën e informacionit aktual në dispozicion:

- Natyra e ndikimeve (d.m.th. jo të drejtpërdrejta, dytësore, akumuluese, të shkurtra, mesatare dhe afatgjate, të përhershme dhe të përkohshme, pozitive dhe negative);
- Mundësia e ndikimit;
- Kohëzgjatja, shpeshtësia dhe riparimi i ndikimit;
- Zona e influencës: Shtirja e ndikimit (zona gjeografike, madhësia e popullsisë/habitatit/specieve të ndikuara) të cilat potencialisht mund të ndikohen. Në lidhje me zonën e influencës, termi “Lokal”, përdoret për ndikimet që ndikojnë burimet lokale ose një habitat të vetëm, në një zonë administrative të vetme (lokale) ose një komunitet të vetëm. Për më tepër, mund të ketë ndikime lokale që mund të

Kompania: ABKONS

Titulli i

 Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

shtrihen përtej, por që janë ende brenda kontekstit (p.sh. brenda një distance prej qindra metrave ose kilometrave nga zonat e projektit; Ndikimet “Rajonale” që ndikojnë burimet rajonale mjedisore, social-ekonomike ose burimet e trashëgimisë kulturore ose që ndihen në një shkallë rajonale siç edhe përcaktohet nga lloji i habitatit, kufijtë administrativ ose komuniteti.

6.2 Përmbledhje e ndikimeve potenciale mjedisore

Zona e ndikuar	Ndikimi Potencial /Burimi	Zona e ndikimit
Ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore	Ndotja e ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor si rrjedhojë e rrjedhjeve/shkarkimeve të pakontrolluara nga automjetet, makineritë, ujërat e ndotur dhe ujërat e zeza, derdhjet aksidentale të materialeve të rrezikshme si për shembull karburant, lëndë kimike, mbetje, etj. Ndotja e ujërave nëntokësor mund të ndikojë tek burimet ujore nëntokësore që përdoren për ujin e pijshëm.	Distancë specifike lokale deri në 100 metra
Toka	Ndotja e tokës mund të ndodhë si rrjedhojë e rrjedhjeve/shkarkimeve të mundshme nga automjetet, makineritë, ujërat e zeza dhe të ndotura, derdhje aksidentale të materialeve të rrezikshme si karburante, lëndë kimike, mbetje, etj. Ndotja e tokës mund të ndikojë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, burimet dhe puset për ujin e pijshëm etj.	Distancë specifike lokale deri në 100 metra
Cilësia e Ajrit	Ndikimet nga emetimet e automjeteve, pajisjet me djegje, aksidente ose defekte të sistemit (d.m.th., aksidente); Trafiku i automjeteve dhe aktivitete operacionale (ngarkimi ose shkarkimi i automjeteve) në rrugë me çakull ose tokë e ekspozuar gjatë lëvizjes që mund të shkaktojë krijimin e pluhurit; Lëshimi i emetimeve në rast aksidentesh (d.m.th. zjarret) mund të bëhet i rrezikshëm për mjedisin, punonjësit dhe banorët, si rrjedhojë e përmbajtjeve të rrezikshme dhe afërsisë së objekteve të banimit. Krijimi i pluhurit mund të përkeqësoj cilësinë e ajrit brenda bazës së furnizimit ose të shqetësoj banorët përreth.	Në nivelin lokal me qindra metra deri në një kilometër në kushte të caktuara të pafavorshme meteorologjike; Komunitetet që përdorin dhe punojnë aktualisht përgjatë rrugëve në të cilat do të kalojnë automjetet e

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

		projektit
Zhurma dhe vibrime	<p>Ndikime nga emetimi i zhurmave gjatë operacionit normal të bazës së furnizimit (d.m.th. automjetet, pajisjet shpërthyes/mekanike). Ngjarje jo rutinë si për shembull ngjarje emergjence.</p> <p>Receptorët e zhurmës do të përfshijnë popullsinë rezidenciale (dhe receptorë të ndjeshëm si shkollat), punonjësit, fauna, etj.</p>	Në nivel lokal, komunitetet që përdorin dhe punojnë aktualisht përgjatë rrugëve në të cilat do të kalojnë automjetet e projektit
Burimet dhe mbetjet	<p>Mbetjet dhe ujërat e ndotur të krijuar nga objekti në studim gjatë operacionit dhe mirëmbajtjes. Kjo përfshin mbetje të krijuara nga aktivitetet që lidhen me magazinën dhe derdhje (mbetje, llum) dhe aktivitetet e ngarkimit dhe shkarkimit.</p> <p>Depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve mund të ndosë tokën, ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor, burimet ujore (ujin e pijshëm) dhe të rrezikojë kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë.</p>	Në nivel lokal, distancat e përafërta varen nga kushtet lokale
Shëndeti dhe siguria në punë dhe e komunitetit	<p>Ndikimet në shëndet dhe në siguri nga emetimet, dëmtimeve nga rëniet dhe makineritë dhe aksidente e të tjera të ngjashme (d.m.th, në rast zjarri).</p> <p>Megjithëse ka pak mundësi, projekti mund të krijojë rreziqe për shëndetin dhe sigurinë e personelit; Projekti ka potencial të ulët për të pasur ndikim mbi komunitetet fqinje nëpërmjet ndryshimeve në nivelin e zhurmave dhe cilësinë e ajrit, etj.</p>	Brenda 100 metrave në nivel lokal
Popullsia lokale	<p>Çdo shqetësim mbi trafikun lokal (lëvizja e kamionëve mund të bezdisin banorët përgjatë rrugës së aksesit), krijimi i pluhurave dhe ndotja e burimeve të ajrit dhe ujit nga çdo emetim ose shkarkim aksidental, etj. Për më tepër, aktivitetet e bazës së furnizimit do të ofrojnë përfitime të kufizuara, kryesisht mundësi punësimi për banorët lokal. Përfitime ekonomike për familjet dhe për ekonominë lokale si rezultat i drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt i projektit.</p>	Në nivel lokal, qindra metra deri në një kilometër
Kushtet e punës	<p>Rreziqe të dëmtimit të fuqisë punëtore si rezultat i aktiviteteve operacionale rutinë të projektit si për shembull mirëmbajtja.</p>	Brenda bazës së furnizimit, në nivel lokal

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

6.3 Përshkrim i ndikimeve potenciale dhe masat zbutëse

Operacionet në objektin në studim krijojnë ndikime të lokalizuara, efektet e të cilave ndihen brenda një zone të lokalizuar. Ndikimet në mjedis duhet të analizohen më së shumti duke u bazuar mbi aktivitetet në mjediset e magazinës, operacionet e makinerive, ekipiet e punës dhe stafit mbështetës brenda objektit dhe zones përreth. Është gjithashtu e rëndësishme që të nënvizohet se aty ku është propozuar të ndërtohet objekti nuk është një mjedis i ndjeshëm. Zona ka një profil industrial dhe rural, kryesisht me tokë të papunuar dhe pak shkurre të shpërndara si dhe disa mjedise industriale jo të organizuara dhe banesa kryesisht informale.

6.3.1 Ndikimet në ujë

Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të ndikohen nga derdhjet aksidentale të materialeve apo mbetjeve, si dhe produktet e mbetjeve gjatë ndertimit të objektit, transportit dhe operacioneve gjatë operimit. Derdhjet si dhe shkarkimet e pakontrolluara të karburantit, lëndëve kimike (duke përfshirë largimin e ujërave të reshjeve), ujërave të ndotura dhe të zeza mund të ndikojnë në cilësinë e ujërave nëntokësore. Megjithatë nuk ka një pritshmëri të kemi ndikime të tilla, planet e parandalimit dhe ndërhyrjes do të trajtojnë këto çdo ngjarje të paparashikuara.

Zbutja e ndikimeve:

Duke përdorur një teknologji moderne, praktikat e sigurisë dhe menaxhimit, shkarkimet ose rrjedhjet e pakontrolluara konsiderohen si shumë pak të mundshme. Megjithatë, masa parandaluese duhet të ndërmerren sipas rastit për të trajtuar çdo ngjarje të pazakontë.

Në raste të tilla, zonat e ndotura duhet të kufizohen. Është shumë e rëndësishme që të shmangen problemet që në hapat e parë, duke eliminuar burimet e ndotjes deri sa ujërat e ndotur të përmbushin standardet për t'u shkarkuar në mjedis. Kështu që, duhet të jenë në dispozicion materiale dhe pajisje për neutralizimin e ndotjeve. Nevojiten të jenë në dispozicion sisteme dhe pajisje të përshtatshme për adresimin e problemeve me rrjedhjet dhe të përfshijnë mbrojtjen nga kullimet për të parandaluar që derdhjet të hyjnë në sistemin e kullimit. Sistemet dhe pajisjet për derdhjet duhet të jenë në përputhje me sasinë e substancave që ruhen. Është gjithashtu e rëndësishme që çdokush që merret me derdhje të mbetjeve duhet të dijë si të përgjigjet siç duhet, në mënyrë që të ofrohen procedurat dhe

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

masat e duhura për derdhjet si dhe stafi duhet të jetë i trajnuar në menaxhimin e derdhjeve të substancave kimike.

Shkalla e rëndësisë: E ulët

6.3.2 Ndikimet në tokë

Në kushte normale, nuk do të jetë e nevojshme të gërmohet apo largohet pjesa e sipërme e tokës. Sheshet e zones të objektit pritet të ngjeshen dhe mbushen me çakull, përfshirë zonën e oborrit. Duhet të shmangen dhe kontrollohet në maksimum fenomeni i erozionit gjatë ndertimit të objektit.

Ndotja e tokës mund të ndodhë brenda ose përreth bazës së furnizimit si rrjedhojë e derdhjeve të mundshme, mbetjeve dhe materialeve të organike.

Masat Zbutëse:

Duhet të shmangen dhe kontrollohet në maksimum fenomeni i erozionit gjatë ndertimit të objektit.

Masa paraprake duhet të ndërmerren për parandalimin dhe neutralizimin e shkarkimeve dhe derdhjeve. Ata duhet të jenë efikase si përmbrojtjen e tokës ashtu dhe për shmangien e ndikimeve të dëmshme mbi të. Operacionet e personelit dhe makinerive duhet të kufizohen vetëm në zonat e funksionimit. Operatori duhet të sigurojë që të mos ketë derdhje të mbetjeve të naftës dhe lubrifikanteve gjatë ndertimit si dhe mbetjeve dhe lendeve organike gjatë operimit të objektit. Në rast të aksidentale këto materiale apo mbetje duhet të neutralizohet siç duhet. Megjithatë, dherat e ndikuara/ ndotura duhet të grumbullohen në një zonë të siguar dhe kufizuar me bankinë derisa të transportohet në një landfill të përshtatshëm.

Shkalla e rëndësisë: E ulët

6.3.3 Ndikimet mbi cilësinë e ajrit

Cilësia e ajrit ka pak të ngjarë që të ndikohet nga aktivitetet që kanë lidhje me projektin. Emetimet e ajrit mund të jenë të konsiderueshme vetëm në rast të zjarreve të hapur ose në rast aksidentesh. Tymi mund të lëshohet në mënyrë të papritur gjatë ndodhjes së aksidenteve

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

dhe do të ndikonte në cilësinë e ajrit në zonën e afërt. Zbatimi i praktikave më të mira industriale mund të parandalojë ndikimet potenciale në shëndet gjatë punës që shkaktohen nga këto tymra.

Masat Zbutëse:

Projekti do të mundësojë përmbylljen e standardeve Shqiptare për ajrin dhe emetimet, përmes përgatitjes së mekanizmave të përshtatshëm parandalues dhe zbutës për të shmangur emetimet e pakontrolluara dhe aksidentet, si Plani për Ndërhyrje ndaj Emergjencave dhe Plani i Menaxhimit për Shëndtin dhe Sigurinë, si dhe duke monitoruar vazhdimisht cilësinë e ajrit.

Vlerësimi i rëndësisë: i Ulët

6.3.4 Zhurma dhe dridhjet

Ndikimet nga zhurma, drita, pluhuri dhe dridhjet nga transporti dhe aktivitetet operacionale mund të bezdisin në mënyrë të përkohshme disa nga banorët përreth. Aktivitetet e transportit të projektit mund të sjellin aksidente për blegtorinë, banorët lokalë, automjete të tjera ose pasuritë e vendasve. Kjo nuk ka të ngjarë që të ndodhë zakonisht, megjithatë plani i menaxhimit do të propozojë masa për të parandaluar aksidente të tilla.

Masat Zbutëse:

Projekti do të bëjë të gjitha përpjekjet që të pajtohet me standardet Shqiptare të zhurmës dhe emetimeve për zonën e projektit, brenda niveleve të lejueshme brenda një distance prej 300 metrash nga objekti. Për të trajtuar çështjet e zhurmës dhe dridhjeve, Kompania do të mundësojë mirëmbajtje dhe monitorim për burimet kryesore të emetimit të zhurmave dhe vibrimeve (si psh. për gjeneratorët, etj.), do të shmang operacionet gjatë natës dhe do të përdor zbutje specifike për pajisjet e zhurmshme.

Vlerësimi i rëndësisë: I ulët

6.3.5 Krijimi i mbetjeve

Ne objekti priten të gjenerohen sasi të vogla mbetjesh urbane, si mbetje të ngurta ashtu dhe ujëra të ndotur urbane. Më e rëndësishme mund të jetë prodhimi ose prania e mbetjeve të organike, si dhe materiale gërryese të cilat paraqesin rreziqe mjedisore (në ujë, tokë, florë dhe fauna, etj.) dhe rreziqe mbi shëndetin dhe sigurinë në punë.

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

Masat Zbutëse:

Për të menaxhuar mbetjet që do të gjenerohen nevojitet një përfaqje e integruar, duke përfshirë parandalimin, menaxhimin dhe masat kontrolluese.

Zonat e magazinimit duhet të ndërtohen duke u bazuar mbi praktikën më të mirë ndërkombëtare për të parandaluar dhe zbutur efektet e derdhjeve. Udhëzime specifike operacionale do të ndiqen për të gjitha aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë procedurat dhe pajisjet e komunikimit dhe mirëmbajtjen e zonës. Të gjitha mbetjet do të mblidhen dhe shpërndahen jashtë zonës në një impiant për menaxhimin e mbetjeve të licencuar nga qeveria për trajtim të veçantë dhe depozitim.

Të gjitha mbetjet jo të rrezikshme të krijuara nga aktivitetet në objekt duhet të ndahen dhe klasifikohen përpara se të ngarkohen në kamionë dhe të çohen në landfille urbane. Praktikën e mbledhjes së mbetjeve duhet të përcaktohen sipas llojit të mbetjeve për të siguruar një menaxhim të sigurt dhe të përgjegjshëm ndaj mjedisit deri sa të dërgohen në një zonë të miratuar për depozitim të mbetjeve për depozitim përfundimtar.

Aktivitetet e magazinimit dhe depozitimit të mbetjeve për mbetjet duhet të rregullohen përmes një Plani për Menaxhimin e Mbetjeve.

Shkalla e rëndësisë: e Ulët

6.3.6 Shëndeti dhe siguria në punë dhe në komunitet

Ndikimet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë operacionale mund të shkaktohen kur kemi të bëjmë me materiale jo të rrezikshme, lëshimin e pluhurit dhe emetimeve, dëmtime nga makineri dhe rrëzime dhe aksidente të tjera të ngjashme (psh.. në rastin e zjarreve). Megjithatë ka pak të ngjarë, për qytetarët lokalë që banojnë afër mund të krijohen problemet për shëndetin dhe siguri në rastin e zjarreve ose aksidenteve.

Masat Zbutëse:

Të gjitha shqetësimet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë diskutohen me detaje në Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit (SMSHSM), megjithatë një përmbledhje e masave zbutëse nënvijëzohet më poshtë.

Kompania dhe kontraktorët e saj duhet të jenë vigjilentë dhe të sigurojnë që rregullat, rregullat e sigurisë dhe standardet të zbatohen në mënyrë të rreptë dhe që kontraktuesi duhet

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

të jetë i vëmendshëm për të siguruar që rregullat e sigurisë janë duke u zbatuar me përpikëri; përgatisë plane evakuimi për impiantet e saj kryesore. Praktikrat e mira për menaxhimin të zonës (trajnim dhe kualifikim i stafit, standarde të duhura të punës) duhet të zbatohen për të reduktuar rreziqet në shëndet dhe në siguri.

Kompania duhet të marrë masat e duhura për të parandaluar aksidentet, duke siguruar magazinimin e sigurt të lëndëve kimike, të mbrojtur nga dëmtimet mekanike dhe dëmtimet e brendshme, të mbrojtur nga temperaturat ekstreme, flakët, dhe të mbuluara/mbyllura pa qenë të ekspozuara direkt ndaj diellit, etj.

Kompania duhet të garantojë sigurinë dhe mjetet e ndihmës së parë brenda bazës së furnizimit, monitorët dhe sistemet e alarmit, pajisjet kundër zjarrit, etj.; për të siguruar që të gjithë punëtorët të jenë pajisur me pajisje të sigurta dhe për të siguruar përdorimin e tyre.

Vlerësimi i Rëndësisë: i ulët.

6.3.7 Ndikimet mbi popullsinë lokale

Cilësia e jetës në komunitetin lokal përreth ka pak të ngjarë që të ndikohet nga aktivitetet që kanë lidhje me projektin; megjithatë një shqetësim mund të shkaktohet nga intensifikimi i trafikut (lëvizja e kamionëve mund të shqetësojë banorët përgjatë rrugës së aksesit), krijimi i pluhurave dhe ndotja e ajrit ose burimeve ujore nga ndonjë emetim aksidental ose shkarkim. Për më tepër, aktivitetet e objektit do të ofrojnë përfitime të kufizuara, kryesisht mundësi për punësim për banorët vendas.

Masat Zbutëse:

Masat zbutëse tëparashikuara për zvogëlimin e pluhurit, mbrojtjen e ujit dhe tokës, parandalimin e emetimeve dhe shkarkimeve, etj. do të parandalojnë dhe trajtojnë çdo ndikim mbi popullsinë lokale.

Kompania do të monitorojë ndikimet sociale që kanë lidhje me projektin dhe do të parashikojë masa zbutëse shtesë nëse nevojitet dhe do të mundësojë identifikimin e hershëm dhe rregullimin e menjëhershëm për ata që besojnë se janë dëmtuar ose shqetësuar nga operacionet në objekt.

Mekanizmi i Ankesave do të përdoret për të lehtësuar identifikimin e hershëm dhe rregullimin e menjëhershëm për ata që besojnë se janë dëmtuar ose shqetësuar nga



DIJE Lokale, Standarde Globale

Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, IshDigitalb
Tirana/Shqipëri

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

operacionet e bazës së furnizimit. Do të sigurojë që ankesat nga komunitetet e ndikuara dhe komunikimet nga grupet e tjera të interesit të marrin përgjigje menjëherë dhe të menaxhohen si duhet.

Vlerësimi i Rëndësisë: I ulët.

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

VII. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM) është një dokument zyrtar detyrues i krijuar nëpërputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare. Ai vendos masat që kanë si synim të parandalojnë, zbusin ose rregullojnë ndikimet potenciale mjedisore dhe sociale që mund të shkaktohen nga projekti i propozuar dhe aktivitetet e tij. PMM aplikohet për të gjitha aktivitetet në objekt. Kërkesat e kësaj PMM-je janë detyruese për kompaninë, kontraktorët dhe nën-kontraktorët e saj në të gjitha kohës derisa të rishikohet ose zëvendësohet nga autoriteti Shqiptar kompetent.

7.1 Menaxhimi i Mbetjeve

Mbetjet e ngurta dhe të lëngshme që do të krijohen gjatë fazës operacionale duhet të menaxhohen sipas planit vijues të menaxhimit të mbetjeve. Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të zvogëluar sasinë e mbetjeve të krijuara, parandaluar dhe zbutur ndikimet e dëmshme mjedisore nga mbetjet dhe pajtueshmëri me standardet kombëtare.

Të gjitha mbetjet dhe substancat e skaduara do të depozitohen jashtë zonës në një landifill të kontrolluar ose në një vendndodhje të miratuar nga qeveria lokale. Zonat e magazinimit do të ndërtohen duke u bazuar mbi praktikën më të mira ndërkombëtare për të parandaluar dhe zbutur efektet e derdhjeve/rrjedhjeve. Depozitimi i mbetjeve në kontejnerë dhe grumbullimi i lëndëve të mbetura janë një çështje e rëndësishme për t'u marrë në konsideratë në dhënien e miratimit mjedisor.

Kontraktori do të mbajë një databazë të dhënash për të gjitha lëndët, e cila do të përdoret për të ndihmuar në menaxhimin e lëndëve kimikebrenda Bazës së Shpërndarjes. Databaza e të dhënave do të mbahet në Departamentin e Shëndetit dhe Sigurisë. Ky sistem do të plotësohet nga inspektimet rregullta për të siguruar që lëndët kimike të ruhen në mënyrë të saktë, etiketohen, transportohen dhe depozitohen.

Udhëzimet specifike të operimit do të hartohen për të gjitha aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve duke përfshirë procedurat e komunikimit, pajisjet dhe mirëmbajtjen e zonës. Fletë me të Dhëna për Sigurinë e Materialeve (FDHSM) do të postohen qartazi në një vend që është lehtësisht i aksesueshëm. I gjithë personeli i autorizuar për të punuar me materialet dhe mbetjet duhet të trajnohet për menaxhimin e duhur të tyre. Është e ndaluar hedhja e mbetjeve

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

në vende publike, në parcela bujqësore, ose në anë të kanaleve të kullimit. Materialet e riciklueshme që janë kanë qenë në kontakt me materialet e rrezikshme dhe të cilat nuk mund të pastrohen në mënyrën e duhur duhet të trajtohen si mbetje të rrezikshme.

Vajrat lubrifikues, tretësit, dhe lëndët vajore duhet të riciklohen si duhet, për t'iu dorëzuar kompanive të licencuara ose transportuar në impiante me djegje (prodhimin e energjisë, furrat e çimentos etj.) ku mund të përzihen me karburant dhe të digjen.

Strategjitë që do të zhvillohen për të ndihmuar në këtë proces përfshijnë:

- Magazinimin në sasi të mëdha të vajrave lubrifikues, hidraulik dhe pjesëve mekanike për të eliminuar nevojën për kontenierë të vegjël.
- Përdorimi i ndarësve të shpejtë të yndyrës dhe detergjenteve që pastrojnë me efikasitet dhe mundësojnë që sistemet ndarëse të naftës/ujit të punojnë me efikasitet
- Magazinimi i të gjitha vajrave që janë duke u përdorur në zona të mbyllura me beton për të minimizuar potencialin e ndotjes së tokës me naftë.
- Një sistem mirëmbajtjeje i planifikuar me efikasitet për të minimizuar mundësitë e dëmtimit të zorrës hidraulike.

Mbetje jo të rrezikshme që përfshijnë ujin larës, naftë e përdorur ose lëndë vajore, mbetjet nga gropa e shkarkimit aksidental, mbeturinat, etj. Praktikrat e depozitimit do të përcaktohen sipas llojit të mbetjeve për të siguruar një menaxhim të sigurt dhe të përgjegjshëm ndaj mjedisit. Koshat e mbetjeve të ngurta të klasifikuar sipas llojit të mbetjeve do të jenë lehtësisht të aksesuesëm në të gjitha zonat e dhe do të ndahen dhe menaxhohen si më poshtë:

- Mbetjet e riciklueshme (duke përfshirë letrën, kartonin, drurin, plastikën, metalin, tekstin dhe mbetjet elektrike/elektronike) do të ndahet dhe dorëzohet kompanitë ricikluese të licencuara
- Mbetjet biodegradueshme do të grumbullohet dhe largohen nga zona e projektit, duke u transportuar në një landfill të autorizuar nga qeveria lokale ose impiant tjetër mbetjesh;
- Mbetje të tjera jo të rrezikshme do të transportohen në një landfill të autorizuar ose impiantetë trajtimit të mbetjeve.

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

Mbetjet Ujore

Të gjitha mbetjet ujore duhet të pajtohen me standardet dhe rregulloret në Shqipëri për cilësinë, temperaturën dhe aromën përpara se të shkarkohen në mjedis, përfshirë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë March 31, 2005 “Mbi Normat e Shkarkimit të Ujërave të Ndotur”.

Mbetjet sanitare

Duke qenë se çdo zonë është e pajisur me kanalizime dhe gropë septike për ujërat e zeza, nuk pritet të kemi impakt në degradimin e tokës dhe nëntokës dhe ujërave sipërfaqësor e nëntokësorë. Nuk do lejohet asnjë shkarkim i mbetjeve sanitare të patrajuara në ujërat sipërfaqësore. Sistemi i depozitimit të mbetjeve sanitare do të bëhet nëpërmjet një sistemi grumbullimi të përbërë nga një tub prej PVC-je (klorur polivinili), që do të përdoret për të kanalizuar mbetjet sanitare drejt ëisternës. Të gjitha mbetjet sanitare do të transportohen me kamionë me vakum në një impiant trajtimi të certifikuar.

7.2 Emetimet

Projekti do të mundësojë pajtueshmërinë me standardet Shqiptare të zhurmës dhe emetimeve për zonën e projektit. Parandalimi i krijimit të emetimeve, zhurmave dhe pluhurit dhe masat zbutëse për të zvogëluar ndikimet potenciale do të zbatohen për të garantuar emetime brenda niveleve të lejueshme në një distancë prej 300 metrash nga vendndodhja e zonës.

Masat vijuese ndaj zhurmës dhe emetimeve do të aplikohen nga Kompania, kontraktorët dhe nën-kontraktorët gjatë të gjitha aktiviteteve në ciklin e projektit.

- Mirëmbajtje dhe monitorimi i burimeve kryesore të emetimit (gjeneratorët, , etj.), shmangja e operacioneve gjatë natës dhe përdorimi i zbutjeve specifike mbi pajisjet e zhurmshme (mbështjellë akustike).
- Të gjitha automjetet dhe pajisjet me djegje duhet të inspektohen para se të përdoren për projektin dhe në vazhdim, për të siguruar që ato janë në një gjendje të mirë teknike.
- Të gjitha automjetet dhe pajisjet duhet të pajtohen në çdo kohë me standardet dhe rregullat përkatëse Shqiptare për emetimet.

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRIBUTION*

- Pajisjet duhet të inspektohen në mënyrë të menjëhershme nëse dyshohet për dëmtime ose mungesë riparimi.
- Pajisjet që gjenden se janë të riparueshme nuk mund të përdoren për aktivitetet e projektit deri sa problemi të korrigjohet.
- Të gjitha automjetet dhe pajisjet duhet t'i nënshtrohen servisit në përputhje me udhëzimet e mirëmbajtjes së prodhuesit.
- Automjetet dhe pajisjet mund të ndryshojnë vetëm në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për të përmirësuar efikasitetin e shpërthimit dhe reduktuar emetimet.

Pluhuri

Trafiku i automjeteve në rrugë me çakull apo të pashtruara dhe aktivitetet operative mund të jetë një burim për krijimin e pluhurit. Rrugët e aksesit duhet të jenë të ujitura rregullisht afër komuniteteve kur është e nevojshme që të kontrollohet pluhuri.

7.3 Automjetet/ Menaxhimi i Transportit

Të gjitha automjetet që lidhen me projektin dhe që përdoren nga Kompania, kontraktorët dhe nën-kontraktorët duhet të pajtohen me normat e mëposhtme të krijuara për kalim të sigurt dhe mbrojtje mjedisore:

- Të pajtohen me të gjitha ligjet dhe rregullat kombëtare dhe lokale përkatëse për transportin dhe mirëmbajtjen e automjeteve.
- Të sigurojnë që shoferët janë të licencuar për automjetin që janë duke operuar.
- Të inspektohet dhe t'u bëhen rregullisht shërbimet e automjeteve për të garantuar një performancë optimale që zvogëlon krijimin e emetimeve, zhurmave dhe dridhjeve.
- Tëmënjanohen automjetet që kanë rrjedhje nga servisi deri sa defekti të rregullohet, për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujrave.
- Të kryejnë mirëmbajtje të automjetit dhe lajnë makinat në hapësira të përshtatshme të krijuara posaçërisht, që ujërat e ndotur të mos shkarkohen në mjedis.
- Të zhvillojnë dhe të pajtohen me procedurat specifike për ngarkimin, transportimin dhe shkarkimin e materialeve të rrezikshme dhe toksike.

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

- Të vendosin kufizime të shpejtësisë për të gjitha automjetet. Kufizimet e shpejtësisë duhet të krijohen për të gjitha zonat ku operojnë automjetet e projektit dhe duhet të specifikohen për kushte të ndryshme drejtimi, lloje rrugësh dhe lloje automjetesh. Duhet të krijohen gjithashtu masa të veçanta për drejtimin afër shkollave dhe receptorëve social të tjerë të ndjeshëm.

7.4 Menaxhimi i burimeve ujore

Zakonisht, aktivitetet që lidhen me projektin do të kërkojnë sasi të vogla uji nga burimet lokale, kryesisht për larje and përdorime të brendshme. Kompania do të bëjë çdo përpjekje për të përdorur me efikasitet burimet ujore pa ndikuar në mënyrë të dëmshme nevojat lokale sidomos gjatë sezonit të thatë. Kompania me shumë mundësi do të porosis ujë të pijshëm me kamionë cisternë (në varësi nga kapaciteti që kërkohet). Vetëm kontraktorë të licencuar do të përdoren për të ofruar ujë, dhe Kompania do të marrë autorizimet e duhura për të përdorur burimin ujor.



DIJE Lokale, Standarde Globale

Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, IshDigitalb
Tirana/Shqipëri

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

VIII. PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR

Plani i Monitorimit Mjedisor është hartuar që të monitorojë operimin dhe masat zbutëse të përcaktuara në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe ndikimet që lidhen me objektin. Këto procedura referohen në këtë VNM, dhe formojnë një pjesë të regjimit të menaxhimit sipas së cilit do të ndërmerret projekti. Procesi i vlerësimit raportuar në këtë VNM ka identifikuar nevojën për masa shtesë specifike zbutëse për të siguruar që projekti të ketë ndikimet më të vogla të dëmshme mjedisore dhe sociale.

Masat specifike për t'u ndërmarrë gjatë fazës operacionale të projektit janë të përfshira në tabelën e mëposhtme. Tabela përfshin gjithashtu masat monitoruese të hartuara për të siguruar pajtueshmëri me planet që mund të kontrollohen dhe dokumentohen gjatë zbatimit, dhe për të caktuar përgjegjësi për këto veprime.

Çështjemjedis ore/sociale	Parametri që do të monitorohet?	Ku do të monitorohet?	Si do të monitorohet? Lloji i mjeteve për t'u përdorur	Kur do të monitorohet? (shpeshtësia)	Pse do të monitorohet?	Kush do te monitoroje?
Ndikimet në ujë	Parametrat e ujit, Ujërat e ndotur	Rrjedha e poshtme e shkarkimeve të ujërave të ndotur (deri në 100 m); Shkarkimet e ujërave të ndotur në ujëra sipërfaqësor; Ujëra nëntokësor shembuj në vende shkarkimi.	Inspektim vizual, Kampionim dhe analizë laboratorike	Gjatë operacionit	Për të verifikuar pajtueshmërinë me kufijtë e lejuar të VKM-së No. 177 të 31 Marsit, 2005 ose kufizime të tjera përkatëse.	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Ndotja e dheut/tokës	Naftë dhe Graso Metalet totale Parametra shtesë në varësi të llojit të ndotjes	Derdhje substancash të rrezikshme, magazinimi i mbetjeve dhe lëndëve	Inspektim vizual, nëse kërkohet kampionim dhe analizë laboratorike;	Gjatë operacionit	Për të zbuluar dhe zbutur çdo ndotje të tokës	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Cilësia e ajrit	Parametrat e ajrit	Burimet e zjarrit/ tymi (për incidente) Ndotje me pluhur dhe ajër gjatë ngarkimit dhe transportimit	Mjete për kontrollin e cilësisë ajrit (Tuba)	Gjatë operacionit	Për të siguruar cilësinë e ajrit, kryesisht afër zonave të banuara Pajtueshmëri me standardet e cilësisë së ajrit dhe adresim i ankesave te publikut;	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Zhurma	Niveli i zhurmës në mjedis (Leq, Max SPL, Min SPL)	300 metra nga aktivitetet e projektit	Instrument i zhurmës	Inspektime rutinë bazuar mbi inspektimin e ankesave (mjetet përkatëse)	Verifikim i pajtueshmërisë me kufijtë e lejuar; Për të siguruar cilësinë mjedisore, shëndetin dhe sigurinë.	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale



DIJE Lokale, Standarde Globale

Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, IshDigitalb
Tirana/Shqipëri

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

Çështjemjedis ore/sociale	Parametri që do të monitorohet?	Ku do të monitorohet?	Si do të monitorohet? Lloji i mjeteve për t'u përdorur	Kur do të monitorohet? (shpeshtësia)	Pse do të monitorohet?	Kush do te monitoroje?
Dridhjet/ vibrimi	Matja e vibrimit	Tek zonat deri ne 300 metra nga aktivitetet e projektit	Instrument	Inspektime rutinë bazuar mbi inspektimin e ankesave	Për të siguruar cilësi mjedisore,shëndet dhe siguri.	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor, Autoritetet Lokale
Krijimi i mbetjeve	Rrezikshmëria/toksiciteti	Zona e ruajtjes së mbetjeve, magazina, zonat e tjera	Inspektimi Vizual Fatura Raporte Analiza te mbetjeve nëse kërkohet	Inspektimet rutinë	Për të siguruar cilësi mjedisore,shëndet dhe siguri. Pajtueshmëri me standardet e menaxhimit të mbetjeve	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor dhe i Punës, Autoritetet Lokale
Shëndeti dhe siguria në punë	Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse Shenjat e Informimit vizual Procedurat SHSM	Në zonë dhe mjediset përreth (nëse kërkohet)	Inspektimi Vizual Kërkesat e Planit të Menaxhimit SHSM Raporte	Inspektimet rutinë	Për të siguruar cilësi mjedisore, shëndet dhe siguri. Pajtueshmëri me standardet e menaxhimit të mbetjeve	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor dhe i Punës, Autoritetet Lokale



DIJE Lokale, Standarde Globale

Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, IshDigitalb
Tirana/Shqipëri

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

					Detyrim për të përdorur PPE dhe shërbimet sanitare.	
Ndikimet mbi popullsinë lokale	Pluhuri, cilësia e ujit dhe tokës, emetimet dhe shkarkimet, prania e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme	Në zonë si dhe mjediset përreth (nëse kërkohet)	Inspektim vizual Kërkesat e planit të menaxhimit SHSM Raportet Masat nëse kërkohen	Inspektime rutinë bazuar mbi ankesat	Për të siguruar cilësi mjedisore, shëndet dhe siguri. Pajtueshmëri me standardet e shëndetit dhe të sigurisë	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor dhe i Punës, Autoritetet Lokale
Ngarkesat dhe transporti	Mbulimi dhe kontrollimi i ngarkesave për të mos shkaktuar shpërndarje/derdhje/shkarkime gjatë transportit për arsye sigurie.	Përgjatë rrugëve lokale	Inspektimi vizual Kërkesat e planit të menaxhimit SHSM Raportet	Inspektimet vizuale (foto)	Shmangja e aksidenteve potenciale dhe shkarkimi i materialeve/substancave	Kompani ose kontraktor Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor, Autoritetet lokale.

IX. Çertifikatën dhe licencën përkatëse të QKL-së



DIJE Lokale, Standarde Globale

Rr. Themistokli Gërmenji
Pranë RTVSH, IshDigitalb
Tirana/Shqipëri

email: info@abkons.com
Tel: +355 4 22 58 326
Fax: +355 4 22 58 326
Web: www.abkons.com

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Magazine 1 dhe 3 kate, *MARKETING DISTRUBUTION*

X. Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit